

E DREJTA PËR INFORMIM



Konsultimi publik i ndryshimeve në ligjin “Për të drejtën e informimit”

Gjatë muajit prill, Ministria e Drejtësisë dhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale organizuan takimin konsultativ për diskutimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit” .

Konstatimi i problematikave, të cilat janë bërë prezent në vijimësi në Raportet Vjetore të Zyrës së Komisionerit, kanë sjellë domosdoshmërinë për të përmirësuar kuadrin ligjor në këtë fushë. Kjo iniciativë vjen e kombinuar edhe me procesin e modernizimit të legjislationit të mbrojtjes së të dhënave personale, duke transpozuar në kuadrin rregullator kombëtar Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave (GDPR) të Bashkimit Evropian (BE). Qasja konstante e Zyrës së Komisionerit ka qënë dhe mbetet edukimi dhe kultivimi i kulturës së transparencës për autoritetet publike.

Edhe në këtë takim konsultativ, përfaqësues të shoqërisë civile ofruan ide e sugjerime të tjera përmirësuese, të cilat do të vlerësohen me seriozitet për të adresuar sa më mirë problematikat e hasura gjatë zbatimit në praktikë të ligjit 119/2014, të cilat u mbajtën shënim nga përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë për ti reflektuar këto sugjerime në draft aktin final që do të paraqitet pranë Këshillit të Ministrave.

PËRMBLEDHJE MUJORE E VENDIMEVE

Vendim Nr. 13 - Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë"

Vendim Nr. 14 - Spitali Rajonal Durrës

Vendim Nr. 15 - Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"

Vendim Nr. 16 - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

Vendim Nr. 17 - Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Spitali Rajonal Shkodër

Vendim Nr. 18 - Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar

Për më shumë informacion klikoni [këtu](#).

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit prill 2023, ka dhënë 6 vendime në zbatim të ligjit 119/2014 për të drejtën e informimit.

Me anë të vendimit nr. 18, datë 26.04.2023, Zyra e Komisionerit ka vendosur pranimin e ankesës ndaj "Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsion dhe Krim të Organizuar (Autoriteti Publik), me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".

Ankuesi, në cilësinë e kërkuesit, ka kërkuar t'i vihet në dispozicion informacioni /dokumentacioni, si më poshtë:

1.Një kopje të plotë të akteve dhe provave gjyqësore të dosjes me nr. Akti, 34 datë 30.10.2015, të paraqitura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për proçedimin penal nr. 245, me datë 16.11.2013, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal;

2.Një kopje të plotë të dosjes gjyqësore me nr. Akti 34, datë 30.10.2015, e regjistruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë me datë 16.11.2013, si proçedimi penal nr. 245, për veprën penale të "Trafikimit të narkotikëve" të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 283/a/2 i Kodit Penal;

Një kopje të vendimit nr. Vendimi 69, datë 18.05.2016, me Kryesuese gjyqtaren Iliriana Olldashi, të dosjes gjyqësore me nr. Akti 34, në ngarkim të të pandehurve ".....,," me akuzën e kryerjes së veprës penale të "Trafikimit të narkotikëve", të kryer në bashkëpunim dhe të mbetur në tentative, të parashikuar nga nenet 283/a/2 dhe 22 të Kodit Penal.

Autoriteti Publik, ka kthyer përgjigje duke ftuar ankuesen pranë ambienteve të Autoritetit Publik me qëllim njohjen me dokumentacionin e kërkuar prej saj, si dhe evidentimin e akteve të cilat ankuesja kërkonte një kopje.

Ankuesja është paraqitur pranë ambjenteve të Autoritetit Publik, ku është njohur me dokumentacionin e kërkuar, si dhe ka evidentuar aktet për të cilat kërkonte të merrte një kopje, takim për të cilin është mbajtur edhe proçesverbali nga ana e Autoritetit Publik.

Në mungesë të marrjes së kopjeve të akteve të evidentuara dhe të një shpjegimi të mëtëjshëm nga Autoriteti Publik, ankuesja, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, Formularin e Ankesës duke kërkuar ushtrimin e kompetencave që i nje ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit, si dhe urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënie e informacionit/dokumentacionit të cituar si më sipër.

Komisioneri, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ankuesja legjitimohet në kërkimin e saj.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Zyra e Komisionerit ka kërkuar të informohet mbi trajtimin apo procedurën e ndjekur lidhur me kërkesën për informacion, si dhe sqarime për disponimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje duke sqaruar se: *"...Në vijim, mbështetur në dispozitat e ligjit të sipërcituar, strukturat përgjegjëse pranë GJKKO shqyrtuan dhe analizuan me kujdes kërkesën e gazetares Lindita Çela (OCCRP), e cila kërkonte kopje të akteve të dosjeve gjyqësore që administrohen pranë GJKKO-së. Në këto kushte, përveç respektimit të parashikimeve të dispozitave të ligjit nr. 119/2014, kërkesa e saj u trajtua në konformitet edhe me parashikimet e neneve 103, 104 dhe 105 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), ku përcaktohen në mënyrë të qartë rastet e ndalimit të publikimit të aktit, shkeljes së ndalimit të publikimit dhe marrjes së kopjeve, ekstrakteve dhe vërtetimeve... Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se, në kushtet kur, në rastin konkret aktet e kërkuara nga kërkuesja konsistojnë në akte gjyqësore të marra në shqyrtim në dhomë këshillimi, si dhe akte që i kthehen prokurorit e që procedimin e çojnë në fazën e hetimit paraprak, zbatohen në mënyrë të menjëhershme edhe kufizimet e vendosura nga ligjvënësi nëpërmjet parashikimit të nenit 103 të KPP, ku përcaktohet shprehimisht se: 1. Ndalohet publikimi, qoftë dhe i pjesshëm i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose vetëm i përbajtjes së tyre ndërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë dhe i pjesshëm, i akteve jo sekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë dhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligjin për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë".*

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se, qëndrimi i Autoritetit Publik nuk është në përputhje me dispozitat e LDI, si dhe detyrimet që burojnë nga ky i fundit.

Refuzimi i dhënies së informacionit me pretendimin e Autoritetit Publik, se shkel dispozitat e parashikuara në nenin 103 të Kodit të Procedurës Penale, pasi çështja për të cilën është kërkuar informacioni nga ankuesja, siç vetë Autoriteti Publik në shkresën nr. 714/1 prot., datë 17.03.2023 ka theksuar *"...aktet e kërkuara nga kërkuesja konsistojnë në akte gjyqësore të marra në shqyrtim në dhomë këshillimi..."*, vlerësohet se nuk është i mbështetur në ligj. Parashikimet e nenit 103 të Kodit të Procedurës Penale, i cili shprehet se: *"1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv. 2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake. 3. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve të shqyrtimit gjyqësor kur gjykimi bëhet me dyer të mbyllura. Ndalimi i publikimit hiqet kur plotësohen afatet e caktuara me ligj për arkivat e shtetit ose kur ka kaluar afati prej dhjetë vjetësh nga data që vendimi ka marrë formën e prerë, por me kusht që publikimi të jetë autorizuar nga Ministri i Drejtësisë."*, nuk mund të aplikohen në rastin konkret pasi çështja është gjykuar në dhomë këshillimi dhe jo me dyer të mbyllura siç shprehimisht kërkon dispozitivi i nenit 103 pika 3. Gjykimi me dyer të mbyllura kryhet vetëm sipas urdhërimeve të nenit 340 të Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon rastet specifike të gjykimit me dyer të mbyllura dhe në zbatim të pikës 3 të nenit 340, gjykata duhet të shprehet me vendim për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura.

Në përfundim Zyra e Komisionerit vendosi, urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas kërkesës për informacion duke respektuar anonimizimin sipas udhëzimit nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor".

Diskutime për “Udhëzuesin standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”

Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) me mbështetjen e Qendrës për Çështjet e Informimit Publik (INFOÇIP) zhvilluan një tryezë në kuadër të diskutimeve për hartimin e “Udhëzuesit standard të marrëdhënies së gjykatës me publikun dhe median”.



Në takim ishte i ftuar Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, anëtarja e KLGJ e caktuar për marrëdhëniet me median dhe publikun, znj. Marçela Shehu, gjyqtarë, ekspertë dhe përfaqësues të mediave. Komisioneri i njohu të pranishmit me veprimtarinë institucionale në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislationit në fuqi në të dy fushat e përgjegjësisë për garantimin e të drejtave themelore të qytetarëve.

Gjatë kësaj tryeze konsultimi publik diskutimet u përqendruan te rekomandimet e përfaqësuesve të mediave në përmirësimin e këtij Udhëzuesi. Qëllimi është vendosja në balancë e misionit të saj për informimin me integritet e profesionalizëm të publikut dhe detyrimin e gjykatave për të ofruar transparencë dhe standarde ligjore që garantojnë të drejtat e njeriut dhe nuk censurojnë punën e medias.



Komisioneri, z. Besnik Dervishi, i ftuar në intervistë në Zërin e Amerikës (VOA)

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, z. Besnik Dervishi, ishte i ftuar në një intervistë për seksionin në gjuhën shqipe të Zërit të Amerikës (Voice of America – VoA).

I pyetur për situatën e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, ndër të tjera ai tha: “nga njëra anë mund ta shikojmë si problematike, por nga ana tjetër mund ta konsiderojmë edhe si ndërgjegjës, si diçka pozitive, si ndërgjegjës të lartë të qytetarëve, të medias, kryesisht asaj investigative dhe veçanërisht, të shoqërisë civile. Në rast se autoritetet publike do të funk-

ciononin shumë mirë do ta jepnin informacionin dhe nuk do të kishte ankesa pranë Zyrës së Komisionerit, dhe nga ana tjetër, janë konstatuar mangësi, pamundësi apo shkaqe të tjera, që ne nga viti në vit i përpunojmë dhe i bëjmë prezente në raportin që paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë.” Në lidhje me garantimin e të drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të kësaj fushe, Komisioneri theksoi: “ne si institucion përgjegjës jemi shumë të shqetësuar, por edhe të gjithë qytetarët duhet të jenë të shqetësuar. Në rradhë të parë, për ndërgjegjësimin e gjithsecilit prej nesh, sepse ne nuk e kemi kulturën e mbrojtjes së të dhënave personale, të mbrojtjes së identitetit tonë.




Ana tjetër, që është po aq e rëndësishme, mbase edhe më e rëndësishme, është pjesa e kontrolluesve, publik (institucionet) apo privat, ku çdo i tillë ka detyrimin kushtetues që t'i përpunojë të dhënat personale në mënyrë të ligjshme, në zbatim të parimeve dhe kritereve të përcaktuara ligjore. Kontrollues janë edhe partitë politike, të cilat, gjithashtu, duhet që përpunimin e të dhënave personale ta kryejnë në përputhje me kuadrin rregullator. Komisioneri ka nxjerrë një seri aktesh në lidhje me rastet e fundit të rrjedhjes dhe cenimit të të dhënave personale të qytetarëve, të cilat janë publike. Kjo është ajo që bën institucioni: monitoron, konstaton shkeljet dhe kur ka vend, vendos sanksione dhe si masë të fundit, urdhëron bllokimin e përpunimit të të dhënave personale kur kemi të bëjmë me shkelje të rënda.”

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale të mëposhtme:



[idp.albania](https://www.instagram.com/idp.albania)



[IDP Albania](https://twitter.com/IDPAlbania)



[Komisioneri KDMDP](https://www.youtube.com/KomisioneriKDMDP)